

KARTELË INFORMATIVE					AL011052
1. Emri i shërbimit	Kërkesë për ripërtëritjen e Patentës për shpikje				
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Vlefshmëria e patentës kushtëzohet nga kryerja e pagesës së tarifës vjetore të ripërtëritjes. Për këtë qëllim pronari i patentës duhet të paguajë cdo vit një tarifë në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale.				
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Tarifa vjetore e ripërtëritjes së patentës, duhet paguar në ditën e fundit të muajit të datës së depozitimit, duke filluar nga viti i parë pas dhënies së patentës. Nëse tarifa e ripërtëritjes nuk paguhet brenda afatit të lartpërmendur, ajo mund të paguhet brenda gjashtë muajve pas ditës së fundit të muajit, në të cilin përfshihet data e depozitimit, me kusht që brenda kësaj periudhe të paguhet një tarifë shtesë. Ky afat mund të zgjatet me dy muaj, duke paguar një tarifë shtesë për shtyrjen e afatit të ripërtëritjes. Nëse DPPI-ja konstaton se pronari i një patente nuk paguan tarifën e ripërtëritjes, ajo njofton pronarin apo përfaqësuesin e tij, brenda dy muajve nga data e mbarimit të këtij afati për mundësinë që ka për të bërë ripërtëritjen, sipas kësaj pike. Njoftimet bëhen vetëm në adresat që pronarët e patentave ose përfaqësuesit e tyre kanë në territorin e Republikës së Shqipërisë.				
4. A jam përfitues?	Individ, Person fizik apo juridik, biznes, OJF, Institucion, Universitet, Qendra Kërkimore dhe kushdo që ka bërë një shpikje.				
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?	
	1	Formular aplikimi për ripërtëritje patente	Aplikanti	Po	
	2	Mandat i pagesës së tarifës përkatëse	Bankë	Po	
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari	
	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)	Tiranë	Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë	E hënë- e enjte, ora 8:00 - 16:30 E premte, ora 8:00 - 14:00	
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1 Ofrohet informacion mbi shërbimin	Niveli 2 Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Niveli 3 Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Niveli 4 Shërbimi ofrohet tërësisht online	
	☒	☐	☐	☐	
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë	Tarifa shtesë	Tarifa Online	Mënyra e pagesës	
	Tarifë ripërtëritje viti II 5,000 Lekë Tarifë ripërtëritje viti III 6,000 Lekë Tarifë ripërtëritje viti IV 8,000 Lekë Tarifë ripërtëritje viti V 10,000 Lekë Tarifë ripërtëritje viti VI 12,000 Lekë Tarifë ripërtëritje viti VII 14,000 Lekë Tarifë ripërtëritje viti VIII 18,000 Lekë Tarifë ripërtëritje viti IX 20,000 Lekë Tarifë ripërtëritje viti X 25,000 Lekë Tarifë ripërtëritje viti XI 27,000 Lekë Tarifë ripërtëritje viti XII 30,000 Lekë Tarifë ripërtëritje viti XIII 35,000 Lekë Tarifë ripërtëritje viti XIV 40,000 Lekë Tarifë ripërtëritje viti XV 45,000 Lekë			Në një bankë (ose në disa banka), jashtë institucionit	
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	3 muaj nga data e plotësimit të dokumentacionit				
10. Çfarë përfitoj?	Njoftim për ripërtëritjen				
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	1 vit				
12. Ku e marr?	Në sportele ☒	Me postë ☐	E-albania ☐	Me e-mail ☐	
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)				
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontakto në:		Orari		
	E- albania: e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al DPPI web: www.dppm.gov.al Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118		Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00		
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele ☒	Me postë ☐	Web-i i Institucionit ☐	Me e-mail ☐	
	Në platformën "Shqipëria që duam" Link: www.shqiperiaqeduam.al		☒		

16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?

*Ligji Nr.9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar ;
Konventa Europiane për Patentat
VKM Nr.1707 datë 29.12.2008 për Miratimin e rregullores "Për lëshimin e Patentave për Shpikje dhe Modelet e përdorimit" e ndryshuar
VKM Nr.883, datë 13.05.2009"Për Miratimin e Tarifave për Regjistrimin e Objekteve të Pronësisë Industriale" i ndryshuar*